



## Aspekte krahasuese: Roli i shoqërisë civile në parandalimin dhe luftën kundër EDH dhe radikalizmit në Ballkanin Perëndimor

Jona Karapinjalli

### Hyrje

Fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që kthehet në terrorizëm ka qenë një çështje tejet e debatueshme dhe me interes të madh publik për shoqëritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky artikull nuk është asgjë më shumë veçse një përpjekje modeste për ta projektuar studimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit përmes lenteve të shoqërisë civile, në mënyrë të veçantë të atyre që gëzojnë statusin e organizatave të shoqërisë civile. Ai synon të sjellë në vëmendje rolin dhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile si një ndër aktorët kryesorë në tërësinë e aktorëve të përfshirë në procesin e parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Ballkanin Perëndimor.

Pozicionimi i organizatave të shoqërisë civile në raport me çështjen, në shkallën e përfshirjes së aktorëve joqeveritarë ka parashkruar se ka disa mënyra dhe rrugë sipas së cilave shoqëria civile mund t'i qaset kësaj dukurie dhe të ofrojë kontributin e saj.

Gjithashtu, interesi për ta elaboruar këtë çështje duke analizuar rolin e organizatave të shoqërisë civile lidhet me faktin se qëndrimi dhe angazhimi i tyre në raport me fenomenin nuk përfaqëson domosdoshmërisht këndvështrimet e strukturave shtetërore, por reflekton një lloj përpjekje të veçantë në ofrimin e zgjidhjeve respektive dhe në përmirësimin e atyre aspekteve ku roli i shtetit nuk është i qëndrueshëm.

### Konteksi i përgjithshëm

Sot, kërcënimet, rreziqet dhe pasojat e ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit janë globale. Vendet e Ballkanit Perëndimor për shkak të trashëgimisë së tyre politike dhe mjedisit socio-ekonomik nuk janë imune ndaj këtij fenomeni.



Kombinimi i faktorëve ekonomikë, shoqërorë dhe politikë si: pabarazia ekonomike, papunësia, niveli i lartë i varfërisë, kriza ekonomike, tranzicioni shoqëror e politik, korrupsioni, fragmentarizimi dhe përjashtimi social, diskriminimi ndaj grupeve të caktuara, mes të tjerash zhgënjimi ndaj qeverisjes dhe partive politike kanë krijuar dashur pa dashur habitanin e nevojshëm në ekspozimin e popullatës përkundrejt këtij fenomeni.<sup>1</sup> Si rezultat i një ndërveprimi të gjerë të faktorëve, shkaqeve dhe stimuljeve të ndryshëm, Ballkani Perëndimor u shndërrua në një qendër rekrutimi për luftëtarë të huaj me pasoja afatgjata shkatërruese për demokracinë. <sup>2</sup>

Duke pasur parasysh përhapjen e gjerë të ekstremizmit të dhunshëm si dhe në përgjigje të interesave strategjike të sigurisë kombëtare, qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor u angazhuan gjerësisht duke përfshirë këtu një sërë aktorësh politik dhe jopolitik, me qëllim krijimin e një mjedisi më të sigurt për të ardhmen.

Organizatat e shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor iu bashkuan agjendës politike për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Ato kanë ofruar një kontribut të konsiderueshëm kryesisht në fushën e hulumtimit të fenomenit, të hartimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve të parandalimit e të ndërgjegjësimit, të përmirësimit të kuadrit rregullator dhe ligjor dhe së fundmi në zbatimin e projekteve të rehabilitimit dhe ri-integrimit të luftëtarëve të huaj të kthyer nga zonat e konfliktit.

OSHC-të në rastin e Kosovës kanë luajtur një rol të rëndësishëm në fushën e kërkimeve dhe hulumtimeve mbi fenomenin e EDH. Ato janë angazhuar në mënyrë aktive në hartimin e politikave publike si dhe zbatimin e programeve të parandalimit, kryesisht me fokus të rinjtë. OSHC-të në Kosovë janë vlerësuar si të suksesshme në advokimin e vlerave demokratike, në promovimin e raporteve ndëretnike dhe dialogut fetar. Gjithashtu, ato i

---

<sup>1</sup> Shih:

<https://www.undp.org/sites/g/files/zskqke326/files/migration/ks/f921466ce017d19f807d37a5dda9654ee27c54b6a45cb7037f44382c85a4477f.pdf>

<sup>2</sup>Shih:[https://ahc.org.al/wpcontent/uploads/2018/06/Manual\\_Ekstremizmit-1.pdf](https://ahc.org.al/wpcontent/uploads/2018/06/Manual_Ekstremizmit-1.pdf)



kanë kushtuar një vëmendje të veçantë "çështjes gender".<sup>3</sup>Aktualisht me mbështetjen financiare të institucioneve ndërkombëtare dhe komunitetit të donatorëve, OSHC-të në Kosovë janë duke punuar me programet e ri-integrimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit.<sup>4</sup>

Në Serbi ka rreth 44 OSHC të angazhuara me programet dhe projektet në fushën e EDH. Një pjesë e OSHC-ve kanë konstatuar se shoqëria serbe ka vështirësi në të kuptuarin e konceptit të EDH për shkak se vetë ky term është parë i lidhur ngushtësisht me kontekstin ku ka lindur fenomeni dhe jo domosdoshmërisht me fenë islame. Ato kanë vlerësuar se duhen bërë ndryshime të menjëhershme në fushën e politikave arsimore dhe të edukimit të të rinjve, për shkak se, këto të fundit konsiderohen si target-grupi më i ekspozuar ndaj këtij fenomeni. <sup>5</sup>

Ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, OSHC-të në Serbi në përgjithësi, janë treguar kritike ndaj autoriteteve shtetërore, faktorit ndërkombëtar si dhe sektorit mediatik në raport me qëndrimin e tyre ndaj çështjes së EDH. Në studimin "Komunitetet të parat", rreth 60 % e tyre e kanë vlerësuar EDH si një problem madhor, 12 prej tyre janë shprehur se qeveria është treguar indiferente ndaj trendit në rritje të ekstremizmit politik të krahut të djathtë si dhe ka injoruar dhunën e grupeve të tifozeve. <sup>6</sup>Disa prej tyre si Qendra për Mbështetjen e Grave janë të mendimit se një pjesë e mediave në Serbi ndikojnë përmes politikës së tyre editoriale në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm.<sup>7</sup>

Në Bosnjë-Hercegovinë, veprimtaria e OSHC-ve në fushën e hulumtimeve mbi këtë fenomen ka qenë e papërfillshme. Për shkak të numrit më të lartë në Ballkanin Perëndimor të individëve të rekrutuar si luftëtarë të huaj, shumica e këtyre OSHC-ve janë përqendruar në procesin e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit

---

<sup>3</sup> Për shembull, Iniciativa e Gruas Kosovare punon drejtpërdrejt me nënat në qytetin e Gjakovës me qëllim që ato ta kenë më të lehtë për të identifikuar sjelljet radikale, veprimet e dhunshme apo shenjat e tjera tek fëmijët e tyre. Shih: <https://www.forum-mne.com/mdocs-posts/al-national-mapping-report-kosovo/>

<sup>4</sup> Po, aty

<sup>5</sup> B.Kostic, V.Simonovic and L.Hoeflinger, "Civil society organizations in preventing and countering violent extremism in Serbia", Mapping Report Cultural Center, Novi Pazar, Beograd:2018 Shih: <https://rc.gradjanske.org/wpcontent/uploads/2019/06/CIVIL-SOCIETY-ORGANIZATIONS-IN-PREVENTING-AND-COUNTERING-VIOLENT-EXTREMISM-IN-SERBIA.pdf>

<sup>6</sup> Po aty,

<sup>7</sup> Po aty,



duke zbatuar projekte ndërgjegjësuere ku në qendër të vëmendjes janë të rinjtë. Ndonëse, disa prej tyre nuk kishin në fokus parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, ato iu përgjigjen nevojës dhe kërkesave të kohës për të ofruar shërbime në fushën e mbrojtjes, shëndetit mendor, ndihmave sociale.<sup>8</sup> Edhe pse OSHC-të janë përpjekur të respektojnë parimin e barazisë në raport me shtrirjen e tyre gjeografike në zbatimin e projekteve, konstatohet se ka shumë pak OSHC të cilat kanë si objektiv grupet e margjinalizuara.<sup>9</sup> Për shembull, në B&H, ndryshe nga rasti i Kosovës rezulton se ka një mungesë të shqyrtimit të pozitës dhe rolit të gruas në politikën parandaluese kundër EDH.<sup>10</sup> Përpos trendit në rritje të OSHC-ve të cilat merren me aktivitetet parandaluese, deri më tani nuk rezulton të këtë OSHC-të që të trajtojnë çështjen e programeve të de-radikalizimit për të burgosurit si luftëtarë të huaj ose të kenë hulumtuar lidhur me rolin e diasporës në raport me radikalizimin me dhunë të individëve.<sup>11</sup>

Bashkëpunimi midis OSHC-ve dhe autoriteteve shtetërore në Malin e Zi në fushën e politikave dhe programeve që kanë në fokus EDH dhe radikalizmin është vlerësuar në nivele të pëlqyeshme edhe pse kërcënimi terrorist është relativisht i ulët. OSHC-të e mëdha në Malin e Zi kanë kapacitete më të zhvilluara kërkimore dhe advokuese, por pjesa më e madhe e punës së tyre është e fokusuar në aktivitetet kulturore. Vlen të theksohet se duke pasur ndikim në popullatën lokale, OSHC-të janë treguar veçanërisht të kujdesshme në punën me minoritetet.<sup>12</sup>

Kriza politike që përfshiu vendin në Maqedoninë e Veriut paralizoi përpjekjet e sektorit të shoqërisë civile në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Raporti i Komisionit European për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022 nënvizoi se ka instrumenta lokalë për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm si dhe janë bërë përpjekje për të ngritur struktura që kanë përgjegjësinë për t'u angazhuar me proceset e ri-integrimit duke synuar edhe përfshirjen e shoqërisë civile në këtë sipërmarrje.<sup>13</sup>

---

<sup>8</sup>Shih: [https://www.qagal.org/ang/publication/regional\\_report.pdf](https://www.qagal.org/ang/publication/regional_report.pdf)

<sup>9</sup> Po aty,

<sup>10</sup> Shih: [https://www.qagal.org/ang/publication/regional\\_report.pdf](https://www.qagal.org/ang/publication/regional_report.pdf)

<sup>11</sup> Shih: [https://www.forum-mne.com/mdocs\\_posts/mne-national-mapping-report-montenegro/](https://www.forum-mne.com/mdocs_posts/mne-national-mapping-report-montenegro/)

<sup>12</sup>Shih: <https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/North%20Macedonia%20Report%202022.pdf>

<sup>13</sup> Filip Stojkovski and Sefer Selimi, "Civil society in preventing and countering violent extremism in Macedonia", Democracy Lab, Centre for Common Ground Macedonia, Shkup:2018 Shih: <https://www.forum-mne.com/en/dokumenti/>



OSHC-të në Maqedoninë e Veriut janë përfshirë gjithashtu edhe në iniciativa dhe projekte kërkimore me qëllimin identifikimin e faktorëve shtytës dhe tërheqës ndaj këtij fenomeni apo edhe evidentimin e komuniteteve në rrezik. Në mënyrë eksplicite ato hulumtuan dhe iu qasën formave islamiste të ekstremizmit të dhunshëm duke mos marrë parasysh ekstremizmin politik në rritje të krahut të djathtë në Maqedoninë e Veriut.<sup>14</sup>

Në Shqipëri, organizatat e shoqërisë civile njëlloj si në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor janë angazhuar kryesisht në proceset e hulumtimeve dhe studimeve ndaj këtij fenomeni si dhe në programet e parandalimit dhe të ndërgjegjësimit mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin me një shpërndarje të pëlqyeshme në zonat me risk të lartë. OSHC-të në Shqipëri kanë reflektuar qëndrueshmëri dhe besueshmëri për shkak se organizimi i aktiviteteve të ndërmarra nga ana e tyre ka qenë në koherencë të plotë me kërkesat e grupeve në nevojë si: Pilotimi i Shkollës Qendër-Komunitare, Forcimi i Policimit në Komunitet apo edhe nisma të tjera lidhur me rritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile, fuqizimin e partnerëve lokalë, ekspertizë hulumtimi në nivel qendror dhe lokal.<sup>15</sup>

Në ligjërimin politik, ato janë vlerësuar nga ana e autoriteteve shtetërore si një aleat i rëndësishëm në përmirësimin e kuadrit rregullator ligjor lidhur me EDH, radikalizmin apo terrorizmin.<sup>16</sup> Por, roli i OSHC-të në Shqipëri ka qenë thujtë inegzistent në monitorimin e proceseve gjyqësore ose hetimore sa i takon procesit të rregullt ligjor dhe respektimit të të drejtave të njeriut të individëve të hetuar dhe gjykuar për veprat penale me natyrë terroriste.<sup>17</sup> Organizata të tjera si: Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (ARCT), Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) dhe Qendra për Korrektim Njerëzor (KRNJ) kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm në ri-integrimin e personave të kthyer nga zonat e konfliktit.

---

<sup>14</sup> Po aty,

<sup>15</sup> Shih: <https://cve.gov.al/>

<sup>16</sup> Shih: <https://mb.gov.al/ekstremizmi-i-dhunshem-kuko-agjencite-modernizojne-sistemet-e-teknologjise-shoqeria-civile-eshte-aleat-ne-ndergjegjesimin-e-komuniteteve-rreth-risqeve/>

<sup>17</sup> Iris Aliaj, "Shoqëria Civile në parandaimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm", Qendra për Nisma ligjore qytetare, Tiranë:2018, fq. 15, Shih: [https://www.qaq-al.org/publikime/alb\\_al\\_2.pdf](https://www.qaq-al.org/publikime/alb_al_2.pdf)



Në nivel vendor, në përmbushje të kauzës kundër EDH dhe radikalizmit, një pjesë e organizatave lokale të shoqërisë civile kanë ndërmarrë nisma me karakter sensibilizues, por janë treguar më pak aktive në identifikimin e rasteve konkrete apo adresimin e zgjidhjeve ndaj tyre. Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike janë një nga mekanizmat që ka rritur bashkëpunimin midis OSHC-ve pushtetit vendor, policisë, gjykatave e prokurorive, komuniteteve fetare, etj. 18

Një nga aspektet pozitive të rolit të OSHC-ve në përmbushje të qëllimit dhe misionit të tyre në luftën kundër EDH dhe radikalizmit është raporti solidar dhe bashkëpunues që ato kanë ndërtuar me njëra-tjetrën nëpërmjet mekanizmave të subgrantimit duke vendosur si preferencë zbatimin e projekteve në partneritet.19

## Përfundime

Organizatave e shoqërisë civile për shkak të kontributit të tyre jetik në procesin e parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit janë konsideruar si një ndër partnerët strategjikë të autoriteteve publike në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ato përballen sot me nevojën e vazhdueshme për financim nga donatorët, disa prej tyre me mungesën e ekspertizës së nevojshme, kurse disa të tjera me mungesën e përfshirjes së tyre gjerësisht në politikat publike kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.20Thuajse të gjitha OSHC-të në vendet e Ballkanit Perëndimor janë të mendimit se midis autoriteteve shtetërore, aktorëve të tjerë jopolitik dhe sektorit të shoqërisë civile mungon një kornizë e mirëfilltë bashkëpunimi.

Luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit është një proces gjithëpërfshirës dhe si i tillë, ai kërkon një angazhim të të gjithë aktorëve të shoqërisë. Në përfundim të këtij punimi rekomandojmë:

---

<sup>18</sup> Shih: <https://www.osce.org/sq/presence-in-albania/480398>

<sup>19</sup> Iris Aliaj, "Shoqëria Civile në parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm", Qendra për Nisma ligjore qytetare, Tiranë:2018, Shih: [https://www.qaq-al.org/publikime/alb\\_al\\_2.pdf](https://www.qaq-al.org/publikime/alb_al_2.pdf)

<sup>20</sup>Shih:[https://www.osce.org/files/f/documents/2/2/400241\\_1.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/2/2/400241_1.pdf)



- Angazhimin e organizatave të shoqërisë civile nga ana e autoriteteve publike në veprimtari që kanë në fokus debatin publik mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin.
- Sigurimin e mbështetjes financiare nga ana e aktorëve politikë shtetërorë për iniciativa të cilat konsiderohen kritike dhe të domosdoshme në proceset e parandalimit dhe kundërshtimit të EDH dhe radikalizmit.
- Promovimin e aktiviteteve, iniciativave dhe masave të ndërmarra nga ana e organizatave të shoqërisë civile që nxisin mendimin kritik në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.
- Krijimin e mekanizmave të rinj të ndërveprimit dhe të shkëmbimit të përvojave në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal me OSHC-të simotra që operojnë në këtë sektor.